



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 9 paragrafi 4, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.04/L-144, nenit 3 të Rregullores QRK 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të nenit 15.2 shkronja d) të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 mars 2018, mori :

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NË PROCEDURËN E DHËNIES TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës, formohet komisioni, në këtë përbërje;

1. Hasan Ajeti, nga Kuvendi i Komunës
2. Endritë Murati, nga Kuvendi i Komunës
3. Abaz Llugaliu, nga Ekzekutivi i Komunës
4. Gëzim Namani, nga Ekzekutivi i Komunës
5. Bardhyl Musa, nga Shoqëria Civile

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni.

Neni 2

Mandati i Komisionit sipas nenit 1 të këtij vendimi është në kohëzgjatje të njëjtë me atë të anëtarëve të Kuvendit, përveç nëse me vendim të veçantë nuk vendose ndryshe.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Rregulloren e QRK-së 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-020/04-0026809/18
Podujevë,
28 mars 2018



Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi